

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-32

759

SABRIGODO

**zëra  
nga  
burime  
të  
nxehhta**

TREGIME



**SABRI GODO**

Lindi në Delvinë më 8 Gusht 1929. Kreu filloren në vendin e lindjes dhe vazhdoi për tre vjet gjimnazin e Tiranës. E ndërpreu shkollën në vitin 1943 për t'u hequr në Ushtrinë nacional-çlirimtare. Shërbeu në ushtri si oficer deri në vitin 1948, pastaj kaloi në pushtet me detyra të ndryshme. Ka botuar dy vepra me karakter letrarohistorik: «PLAKU I BUTKËS» në vitin 1964 dhe «ALI PASHË TEPELENA» në vitin 1971.

891.583-32

5

859

SABRI GODO

ZËRA  
NGA BURIME  
TË NXEHTA

Tregime

~~56775~~

960

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## Mëngjezi i një dite qershori të vitit 1944

Isha në vëndrojen prej dy orësh. Ndërresa duhej të kishte ardhur, po kompania vazhdonte mbledhjen. Diskutohej situata politike. Shtabi i brigadës kishte njoftuar hapjen e frontit të dytë në Francë.

Unë shikoja gurët e bardhë të kilometrazhit, që vinin varg nga Vlora, si një spërkatje e ngrirë e qytetërimit, me të cilin i kishim prerë lidhjet prej kohe. Ishin pesë gurë. I gjashti gjendej pas kthesës.

Këtë lajm mbi frontin e dytë ne e kishim marrë që në mëngjez edhe nga ajri dhe çuditësha se çfarë diskutonte kaq gjatë kompania. Sigurisht do të kishte bërë pyetje Sefedini. Aeroplanat anglezë patën hedhur natën gazetën «Mundimi». Në faqen e parë të asaj fletushke gjithnjë botonin fotografinë e kryeministrit Çerçill. Ishte tepër i ngjallur, me një puro në dorë dhe me një palë sy që nuk të ndaheshin. Mbase ishte nga shkaku i atyre syve, si edhe i puros së ndezur, që më dukej se diçka fshihej dhe digjej heshtur nëpër radhët e asaj gazete. Xha Arifi e shihte punën ndryshe. Ai i paloste me kujdes ato gazeta, se kishin një letër të hollë për cigare. Atë mëngjez ai tha se kushedi sa komunikata do të hidhnin aleatët në Francë.

Gurët e bardhë, si dhe tyrbeja e vetmuar, me të cilën kisha një farë llogarie, ishin objekte tepër të heshtura, për të vijuar bisedën me një roje. U ngrita, në këmbë përsëri.

Kodrat e veshura me blerimin më të gjelbër që kisha parë ndonjëherë shtriheshin përpara si t'u donte qejfi, gjer buzë Vjosës. Ishin të mbjella me një grurë, që nxinte nga shëndeti. Gruri rritej me drojtje dhe nuk e dija se kur e kishin mbjellë njerëzit atë, se njerëz nuk dukeshin fare. Kodrat ishin tonat. Tonat ishin edhe malet e Lapardhasë, të kalτέρα, sikur mbi to të kishin kërcyer dikur valët e detit, t'i kishin larë e t'u kishin dhënë ngjyrë. Pra-pa meje, në të djathtë e në të majtë, shtrihej Zona e Parë Operative, vend i lirë. Dhe në tërë anët, nga të ktheje sytë, kishte vetëm një pikë të errët: Mavrova. Atje ishin gjermanët, që ndriçonin natën luginën me raketa. Ngjyrat e asaj luginë i kisha thithur aqë tepër sa më dukej edhe vetja i gjelbër. Aty asgjë s'lëvizte, përveç urisë, që ishte e pandarë.

Nga mërzia, ashtu si edhe herë të tjera, fillova të numëroja gjer në njëmijë, gjer në dymijë. Kisha arritur në këtë shifër rrumbullake, kur dëgjova tri krisma pushke dhe një bombë dore. Ishte shenja e alarmit nga Qafa e Dushkut. Atëhere zbraza edhe unë pushkën tri herë. Pastaj hoqa nga mesi të vetmen bombë që kisha, i shkula gjuhën dhe e flaka rrëzë kodrës. Ajo krisi me potere të madhe dhe ngriti pluhur. Ishte e markës «Societa Romana» dhe nuk të vriste fare.

Si i mbarova këto punë, më erdhi për të qeshur, se m'u duk sikur bëra një copë luftë me veten time. Po era e njohur e barutit më përmendi. Unë po përsëritja alarmin. Kjo ide më tronditi dhe më

gëzoi. Nga prilli e këtej, s'kishim bërë tjetër, veç kishim ndenjur në fshatin Vajzë, ku nuk gjendej asnjë mace e gjallë dhe ku çdo gur ishte djegur nja tri herë. Kishim ndenjur atje me racion ditor 500 gram bukë dhe një gavetë dhallë. Bënim stërvitje dhe një herë në javë, kritikë e autokritikë dhe e gjitha kjo na e kishte sjellë shpirtin në majë të hundës, po asnjëri nuk e thoshte me gojë.

Ne ishim çeta «Sulo Hyso» e batalionit «Baba Abaz Rabia» që, ku e zinte dreka, nuk e gjente nata. Ne kishim vazhduar t'i binim rrotull Toskërisë edhe si u bëmë kompani II e batalionit III të Brigadës VI S. Ne s'kishim fjetur kurrë dy net me radhë në një vend. Nuk na e kishte marrë mendja që të rrinte një repart partizan, në një fshat tërësisht të djegur e të përmbysur shtatë javë me radhë.

Prandaj u gëzova shumë që po u jepja alarmin shokëve. Mua as që më shkonte ndër mend se po njoftoja kompaninë, batalionin dhe komandat e vendit, sa hante jehona e pushkës, se atë ditë fillonte Operacioni i madh i qershorit.

\*  
\*   \*  
\*

Diellin e kisha mbi kokë dhe nuk më pengonte, po doja të shihja sa më larg dhe kisha vënë dorën mbi sy. Atë çast u dha në vendroje Gjoleka, komandanti. Ai u ngjiti majë kodrës dhe u shtri. Unë shkova pas tij. Tani isha vërtet i gëzuar, se nuk ndjeja më asnjë përgjegjësi.

— T'op — tha Gjoleka. Ai më kaloi dylbinë.

Në xhadenë e Qafës së Dushkut po rrëshqiste duke ngritur pluhur një maqinë. Ajo po gryente

kodrën e veshur me një pyll të shkurtër. U rrëqetha, sikur të kisha ndjerë mbi trup një bubuzhel. Kur maqina doli përsëri nga kthesa, pamja m'u kthjellua menjëherë. Ishte një autobлиндë, që tërhoqte prapa një top.

Gjoleka kishte kthyer kokën që të shikonte nëse po ngjitej kompania në pozicione. Pashë fytyrën e tij të zbetë dhe ndesha në shikimin e tij të shqetësuar. Ai më shikoi një çast dhe mua m'u duk se nuk më pa fare.

Gjoleka mori dybinë dhe zverku i tij i hollë e i nxirë u ndeh përpara. Autoblinda, duke rritur shpejtësinë, kishte dalë në kurrizin e kodrave dhe unë po habitesha si nuk përmbysesj ajo në kthesa, ndërsa pluhuri rrinte pezull mbi xhadenë e pashkelur prej kohe.

— Tani do fluturojë. Të vejë me shëndet! — tha Gjoleka, duke u ngritur në bërryla.

Autoblinda kaloi vendin e minuar dhe u duk sikur anoi pak nga e majta, po në çast u drejtua dhe u turr drejt nesh.

Në kthesën e fundit, tek ullishtat, autoblinda frenoi në vend. Grykët e dy mitralozave të saj u rrotulluan, duke kërkuar një pikë për tu fiksuar. Ajo dukej si një kafshë e vogël e uritur dhe kërcënimi që u bënte maleve ishte qesharak. Deri atë çast nuk më kishte rënë ndër mend të pyesja se ku shkonte ajo autobлиндë e vetmuar. Po, kur frenoi, e kuptova përse shikonte Gjoleka aty më parë si i hutuar, tej meje dhe tej autoblindës. Ajo bënte zbulim. Tani do të shihnim se ç'do të bënte ajo për të na zbuluar, çfarë mjetesh do të përdorte dhe cilat ishin dredhitë e saj.

Ushtarët që rrinin të kapur pas autoblindës,

kërcyen poshtë, zbërthyen topin dhe e drejtuan. Lëvizjet e tyre ishin të shpejta, të sigurta, si në një lojë gjimnastike. Nuk vura re se nga mbinë ndërkohë dy ushtarë të tjerë, që dolën te tyrbeja mbi rrugë dhe vendosën atje një mitra-loz. Dhe, para se të kuptoja atë që po ngjiste, topi u zbraps i egërsuar dhe mbi ne fluturoi predha e parë, që plasi në fshat, duke rrëzuar ndonjë mur të mbetur. Pastaj çanë ajrin me shpejtësi rrëmbe-njëse predha e dytë dhe e treta.

Ajo ishte një punë krejt e kotë dhe desha të dija se ç'mendonte Gjoleka. Më kaloi menjëherë i tërë emocioni. Përse bënin gjithë atë shamatë gjermanët me gurët e djegur të Vajzës?

Gjoleka gradoi shënjestrën në tetëqind metra dhe uli kokën. Pastaj hoqi dorë. Ai i jepte rëndësi autobлиндës dhe diçka mendonte.

Sipër, në kala të Plloçës, plasi një krismë e dobët. Megjithatë ne e dëgjuam qartë. Disa çaste më pas, gjatë të cilave ne mbajtëm frymën, në qiell u ndeh një vërshëllimë si hark. Po dilte në shesh artileria jonë. Predha e parë e mortajës u zhduk në përrua dhe neve na erdhi turp, po e dyta u drejtua mirë dhe ngriti një shtëllungë pluhuri në mes të xhadesë. Topi i dha përgjegje kalasë me dy të shtëna, po në predhën e tretë të mortajës ushtarët ju lëshuan topit, e kthyen dhe e lidhën. Gjoleka shtiu i pari, pastaj unë. Kishte fare pak shpresë të bënim punë në atë largësi. Mitralozi nga tyrbeja lëshoi një breshëri të gjatë, me dy gjuhët e njohura të «Sharsit».

Motori i autobлиндës gjëmoi dhe përhap i në luginë panikun që e kishte zënë. Autoblinda u rrotullua rreth vetes dhe ushtarët u ngjitën pas saj.



Gjermanët po niseshin me shpejtësi, kur mortaja e batalionit u lëshoi nga prapa predhën e katërt. Ne e pamë me sy tek fluturonte, si një pulë e zezë, me krahët mbledhur. Edhe për pak do t'i binte autoblindës në kokë.

— Të lumtë, barba Petro — thirri Gjoleka. Mua më hidhej zemra nga gëzimi. Barba Petrua shtinte me atë qyngjin e tij, pa dylbi dhe pa gonio-metër. E drejtonte me dorë, si topat qëmoti, kur u shpikën për të parën herë, po nuk gabonte dhe aqë në shenjë. E shikojta me mend, fare të gjallë, se qysh rrinte atë çast, në mes të tri arkave të tij të municionit dhe kruante i dëshpëruar qimet e ver-dha të mjekrës.

\*  
\*   \*  
\*

Gjoleka urdhëroi të kontrollohen minat dhe unë thirra Foton.

— Foto! O Foto! Hajde, se do shohim bukët.  
— Dha urdhër Gjoleka.

Fotua po zbriste poshtë. Një buzëqeshje tërë përbuzje i varej në anën e djathtë të gojës. Ishte dështimi i tij i dytë si specialist i minave angleze. Aty më parë, kur ishte kthyer nga kursi, Fotua kishte thënë me mburje: «Vetëm një herë gabon xhenieri». Kjo fjalë e re e kishte ngritur shumë rëndësinë e Fotos në sytë tanë. Ai mbante një kapë të bukur aviatori gjerman, që s'dihej ku e kishte gjetur. Tek zbriste poshtë, m'u duk sikur ajo kapë i sillte tani siklet.

Fotua u nis përpara. Shikojta zverkun e tij të pjekur dhe shpatullat e mëdha rumbullake. Ai ishte si një fëmijë i rritur. Hapat tona ushtonin në xha-

denë e thatë. Ndjehej era e autoblinës. Në të djath-të na doli përpara tufa e murizave të larta që bënin një hije të errët. Aty ishte tyrbeja dhe që të dy kthyem kryet gjetkë. Javën e kaluar patëm marrë nga tyrbeja nga një kile grurë të zier për shok. Ishte një grurë kokërmadh e i shndritshëm, që nuk më kishte takuar të shihja gjer ahëre. E drejta është se nuk desha ta merrja. Jo për ndonjë paragjykim fetar. Po, edhe kjo më dukej një farë vjedhje.

Po Fotua tha se gruri do të kalbej në kamaren e tyrbesë dhe do ta hanin mizat. Ishim kthyer nga zbulimi. Bisedën e bënim aty më këmbë, me bërrylat mbështetur në kamare, ndërsa nga fshati vinin zërat e shokëve, të rreshtuar para kazanit. Fotua shtriu dorën, i tundi kokrrat e grurit në pëllëmbë, i futi në gojë dhe gati u mbyt.

— Të zuri gjynahu — thashë unë.

Ai qeshi. Duke qeshur, e zbrazëm kamaren.

Nga ajo ditë e prapa, unë dhe Fotua i rrinim larg njëri-tjetrit, por tani, si e kaluam atë tyrbe të prishur e të dhunuar, që të dy menduam se nuk kishim ndonjë faj për punën e grurit. Unë shpejtova hapin dhe dola në krah të Fotos. Ai po vërshëllente një këngë.

Vendin e minave e gjetëm të maskuar mirë, siç e kishim lënë. Fotua mbështeti pushkën dhe i erdhi vendit rreth me një hap të drojtur, sikur po shkelte pranë një varri. Ai më kishte harruar mua.

— Të vdekura janë — thashë unë — dhe të varrosura.

Fotua filloi të pastronte dheun me duar. Gjash-të copa mina zbuluan kurrizin. Ishin vënë mbi një dërrasë, në vijë të drejtë, si bukët në lopatën e fur-